



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 425/3 Prot.

Tiranë, më 02.02 2024

VENDIM

Nr. 9 datë 02.02 2024

“PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, PËR PERIUdhËN 2024-2028

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 11 datë 02/02/2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 02.02.2024,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës për periudhën 2024-2028.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT 2024-2028

HYRJE

UNIVERSITETI I SPORTIT I TIRANËS është i vetmi institucion i arsimit të lartë i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë. Universiteti realizon kualifikimin e plotë shkencor të specialistëve të edukimit fizik dhe sportit, rekreacionit dhe rehabilitimit deri në nivelin "Master i Shkencave" dhe "Doktor i Shkencave".

Zanafilla e Universitetit të Sporteve të Tiranës nisi me ngritjen e Shkollës Teknike të Edukimit Fizik në vitin 1948, si shkolla e parë e mesme që përgatit mësuesit e ardhshëm të edukimit fizik. Pas 10 vjetësh, në vitin 1958 u krijua Instituti i Lartë i Edukimit Fizik.

Që nga viti 2010, ky institucion ka statusin e universitetit, ku në përbërjen e tij janë tre fakultete dhe një institut kërkimor.

Katër njësitë kryesore të UST-së janë:

- I. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
- II. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit;
- III. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit;
- IV. Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit.

Programet aktuale që zhvillohen në universitetin tonë janë:

- 3 (tre) programe bachelor;
- 3 (tre) programe master shkencor
- 4 (katër) programe master profesional;
- 2 (dy) programe doktorature;
- 1 (një) program i shkurtër me 35 kredite.

UST-ja është veçanërisht e interesuar për ndërkombëtarizimin e programeve të saj të studimit dhe në këtë mënyrë kërkon të ndërtojë partneritete të suksesshme me institucione të tjera në rajon dhe në Evropë.

Në përputhje me mësime të mësimdhënien, kërkimi është po aq i rëndësishëm për misionin që ka universiteti. UST ka një grup ekspertësh, studiuesish, pedagogësh dhe menaxherësh projektësh shumë të kualifikuar dhe punon ngushtë me një rrjet të mirë-krijuar të institucioneve të arsimit të lartë, bizneseve, instituteve kërkimore dhe aktorëve të tjerë.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është i përfshirë në projekte të ndryshme evropiane në Arsimin e Lartë dhe Sport me qëllim përmirësimin e procesit të të nxënies dhe mësime të mësimdhënies si dhe kryerjen e kërkimit shkencor.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është universiteti më i renditur, sipas agjencisë së akreditimit të arsimit të lartë në Shqipëri (UST është akredituar nga një bord ndërkombëtar me maksimum 6 vjet).

Ndërkombëtarizimi është një nga objektivat parësor të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe zë një pjesë të rëndësishme dhe integrale të strategjisë së zhvillimit të institucionit, e cila ka të vendosura objektiva të qarta afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në lidhje me ndërkombëtarizimin e mëtejshëm të universitetit. Ne e konsiderojmë ndërkombëtarizimin e universitetit si instrument për arritjen e ambicies për t'u bërë një pikë referimi rajonal dhe ballkanik për fushën e shkencave sportive.

Në përmbushje të misionit të tij UST vë theksin tek mbështetja e shkëmbimeve ndërkombëtare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor duke nxitur bashkëpunimin me universitete dhe partnerë të tjerë kudo në botë.

Përfaqsjë ndërkombëtare e universitetit përfshin dhe harmonizon aspekte të ndryshme të jetës universitare: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe administrimin. Në këtë kuadër, UST është përkushtuar për t'i dhënë një përmasë dhe prani ndërkombëtare kërkimit që zhvillohet në universitet, botimeve që realizohen nga universiteti e nga stafi akademik brenda dhe jashtë përmes punimeve prestigjioze të njohura ndërkombëtarësisht, si dhe shkëmbimeve të studentëve, stafit akademik dhe administrativ me universitete partnere të rinj dhe të vjetër, si dhe krijimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në vitin 2024, UST numëron me shumë se 30 universitete partnere në botë, me të cilët ka lidhur një sërë bashkëpunimesh në fushën e kërkimit, mësimdhënies, botimeve të përbashkëta, si dhe të shkëmbimit të stafit dhe studentëve. 10 anëtarë të stafit akademik janë profesore të njohura në fushat e tyre ndërkombëtarisht. Po ashtu, universiteti ka lidhur 7 marrëveshje ndërinstitucionale përmes programit Erasmus+ për shkëmbime të stafit dhe studentëve. Të gjitha këto janë dëshmi e vullnetit për ta bërë ndërkombëtarizimin realitet të prekshëm në universitet.

1

OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

UST si i vetmi universitet publik në fushën e shkencave sportive ka për qëllim kryesor të jetë një aktor i rëndësishëm në zhvillimin social, ekonomik, sportiv e shëndetësor jo vetëm brenda vendit por dhe në rajon e më gjerë, duke i ofruar studentëve dije dhe njohuri akademike cilësore në përputhje me standartet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

UST synon të bëhet një nga universitetet shqiptare në fushën e shkencave sportive më të njohura ndërkombëtarësisht duke forcuar orientimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Objektivi kryesor është krijimi i një profili besueshmërie dhe profesionalizmi në lidhje me mësimdhënien, kërkimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të projekteve të kërkimit, zhvillimit apo bashkëpunimit për rritjen e kapaciteteve njerëzore në mënyrë të ndërsjellë.

UST synon që përmes realizimit të këtij objekti të bëhet njëkohësisht strehë e vlerave dhe pikëtakimeve kulturore e sportive duke forcuar jo vetëm bashkëpunimin ndërkombëtar, por duke u bërë edhe nxitës i tolerancës ndaj, respektit për dhe njohjes së kulturave të ndryshme.

Për përmbushjen e objektivave të përgjithshëm, UST ka përcaktuar një sërë objektivash afatgjatë, të cilat përqëndrohen në këto aspekte strategjike:

- I. partneritet institucional;*
- II. përvojë ndërkombëtare për studentët dhe stafin akademik dhe administrative;*
- III. ndërkombëtarizim i programeve dhe kurrikulave,*
- IV. bashkëpunim ndërkombëtar në kërkim, zhvillim dhe transferim njohurie dhe teknologjive.*

2

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

Objektivat strategjikë synojnë përfshirjen e universitetit në aktivitete dhe ndërmarrje të reja për të arritur ndërkombëtarizimin si më poshtë vijon:

- 1- Nxitjen e mobiliteteve të studenteve dhe stafit akademik dhe administrative;*
- 2- Nxitjen dhe mbështetjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive dhe teknologjive;*
- 3- Forcimin e lidhjeve me diasporën shkencore shqiptare;*
- 4- Rritjen e vizibilitetit ndërkombëtar të universitetit jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë;*
- 5- Forcimin e strukturave administrative mbështetëse për realizimin e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë;*
- 6- Ndërkombëtarizimin e programeve dhe kurrikulave;*
- 7- Ndërgjegjësimin për komponentin ndërkulturor në marrëdhënie me partnerët ndërkombëtarë.*

A - REALIZIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË

Objektiva strategjike	Synimi	Si do të arrihet
D) Nxitja e mobiliteteve të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ	<ul style="list-style-type: none"> ○ Rritja e mundësive për lëvizje për studentët dhe stafin e UST-së. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përmes marrëveshjeve aktuale që UST ka me universitete të tjera; ➤ Përmes marrëveshjeve ndërinstytucionale që UST ka nënshkruar aktualisht nën komponentët programit Erasmus + dhe programeve të tjera; ➤ Përmes nxitjes së stafit për të aplikuar për të siguruar marrëveshje të tjera ndërinstytucionale për shkëmbime përmes programeve të Bashkimit

		<p><i>Evropian etj;</i></p> <p>➤ <i>Përmes rritjes së numrit të stafit mësimdhënës të UST-së në universitete të huaja dhe anasjelltas.</i></p>
<p>2) Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive dhe teknologjive.</p>	<p>○ Promovimi dhe njohja ndërkombëtare e punës kërkimore-shkencore të drejtuar dhe kryer nga stafi i UST-së.</p>	<p>➤ <i>Përmes nxitjes e kapaciteteve njerëzore të UST-së në kërkim, zhvillim, teknologji për të promovuar punën e tyre.</i></p> <p>➤ <i>Përmes rritjes së cilësisë dhe vërtetësisë së punës kërkimore, zhvillimore, teknologjike në UST-se.</i></p> <p>➤ <i>Përmes paraqitjes së punës kërkimore, zhvillimore, teknologjike në UST-se në aktivitete ndërkombëtare.</i></p>
	<p>○ Faktimi i përmasës ndërkombëtare të aktiviteteve të kërkimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive dhe teknikave e teknologjive të perdorura e realizuara nga UST</p>	<p>➤ <i>Përmes përfshirjes në aktiviteteve dhe projekte kërkimore e zhvillimore ndërkombëtare.</i></p> <p>➤ <i>Përmes rritjes së besueshmërisë ndaj kapaciteteve njerëzore të UST-së në kërkim, zhvillim, teknologji tek partnerët ndërkombëtarë.</i></p> <p>➤ <i>Përmes realizimit të botimeve të përbashkëta.</i></p>
<p>3) Forcimi i lidhjeve me diasporën shkencore shqiptare.</p>	<p>○ Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes lidhjeve me diasporën shqiptare.</p>	<p>➤ <i>Përmes identifikimit të diasporës shkencore shqiptare.</i></p> <p>➤ <i>Përmes nxitjes së stafit për të thelluar bashkëpunimet me kolegët e tyre në universitete ndërkombëtare.</i></p> <p>➤ <i>Përmes organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare shkencore dhe botuese.</i></p>
<p>4) Rritja e vizibilitetit ndërkombëtar të universitetit jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë.</p>	<p>○ Prani më e madhe në aktivitete dhe projekte me karakter shkencor, kërkimor dhe zhvillimor.</p>	<p>➤ <i>Përmes rritjes së numrit të aplikimeve në projekte ndërkombëtare si lider ose si partner.</i></p> <p>➤ <i>Përmes nxitjes së stafit për të thelluar bashkëpunimet me kolegët e tyre në universitete ndërkombëtare.</i></p> <p>➤ <i>Përmes organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare shkencore dhe botuese.</i></p>

<p>5) Forcimi i strukturave administrative mbështetëse për realizimin e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Strukturim efikas i zyrave administrative mbështetëse për marrëdhëniet me jashtë dhe projektet. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përmes trajnimit të stafit aktual të zyrave për mbështetje të stafit akademik në shkrimin e projekteve. ➤ Përmes rekrutimit të një stafi të kualifikuar në marrëdhënie me jashtë dhe shkrim projektesh.
<p>6) Ndërkombëtarizimi i programeve dhe kurrikulave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Përmirësimi i programeve në reflektim edhe të përvojës ndërkombëtare. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përmes programeve që mbështesin mobilitete të studentëve dhe stafit. ➤ Përmes programeve që nxisin mësimdhënien dhe mësimnxënien në disiplina bashkëkohore dhe që mbështesin rritjen e kapaciteteve njerëzore në kërkim dhe zhvillim. Përmes rritjes së numrit të programeve të studimit në gjuhën angleze. ➤ Përmes rritjes së numrit të programeve të përbashkëta.
<p>7) Ndërgjegjësimi për komponentin ndërkulturor në marrëdhënie me partnerët ndërkombëtarë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Rritja e ndërgjegjësimit ndërkulturor të stafit administrativ. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përmes ndërgjegjësimit të stafit administrativ përgjegjës për larminë e kulturave të stafit dhe studentëve ndërkombëtarë në UST. ➤ Përmes rritjes së mundësive për mobilitet të Stafit administrativ me qëllim njohjen dhe vlerësimin e përvojës dhe kulturës së huaj. ➤ Përmes trajnimit të stafit administrativ në universitete ndërkombëtare.

B- MATJA E ARRITJEVE

Realizimi i këtyre objektivave do të matet përmes mjeteve të mëposhtme:

- Të dhënave statistikore në lidhje me numrin e studentëve të huaj në UST, stafit të huaj në UST, projekteve të fituara nga UST, aplikimeve nga UST, partneriteteve të UST-së me universitete të tjera;
- Studimeve dhe vëzhgimeve me studentët e huaj;
- Studimeve dhe vëzhgimeve me stafin e huaj;
- Të dhënave kërkimore;
- Numrit të mobiliteteve të përfituara.